



Qeveria e Kosovës  
Vlada Kosova - Government of Kosovo Qeveria -  
Vlada - Government  
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister  
Zyra për Qeverisje të Mirë / Kancelarija za Dobro Upravljanje / Office on Good Governance



**RAPORT VJETOR PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE PUBLIKE PËR ORGANIZATAT JO-QEVERITARE  
NË REPUBLIKËN E KOSOVËS PËR VITIN 2025**

QERSHOR 2026

## TABELA E PËRMBAJTJES

LISTA E SHKURTESAVE .....	3
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	4
FJALË HYRËSE.....	5
1. HYRJE.....	7
1.1 Metodologjia e përdorur.....	7
2.TË DHËNAT E PËRGJITHSHME PËR RAPORTIMIN NGA INSTITUCIONET/ORGANIZATAT BUXHETORE .....	7
2.1 Raportimi nga organizatat buxhetore sipas rregullores.....	7
2.2 Digjitalizimi i raportimit.....	7
2.3 Përgjegjësitë dhe lidhja me ligjin për menaxhimin e financave publike.....	7
2.4 Përmirësimet dhe sfidat në raportim .....	8
2.5 Pjesëmarrja e institucioneve në raportimin për vitin 2025.....	8
3. TË DHËNAT MBI FINANCIMIN PUBLIK SIPAS INSTITUCIONEVE .....	14
3.1 Shumat dhe projektet e mbështetura .....	14
3.2 Niveli qendror: ZKM dhe Ministrinë .....	17
3.3 Niveli lokal: Komunat .....	18
3.4 Të dhënat e përgjithshme për vitin 2025 .....	20
3.5 Krahasimi ndër vite 2024–2025 .....	22
4. QËLLIMI I MBËSHTETJES FINANCIARE .....	27
4.1 Objektivat e përgjithshme .....	27
4.2 Platforma dhe mekanizmi i raportimit .....	27
4.3 Avancimi i procesit të raportimit .....	27
4.4 Rekomandime për përmirësim .....	27
4.5 Përfitimet institucionale .....	27
5. TË DHËNAT E DETAJUARA PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE.....	28
5.1 ZKM dhe ministrinë .....	28
5.2 Komunat.....	29
5.3 Numri i projekteve të mbështetura .....	31
5.4 Analiza krahasuese ndër vite .....	33
7.KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME .....	44
7.1 Konkluzionet kryesore.....	44
8. ANEKSET .....	45
8.1 Lista e OJQ-ve përfituese sipas ZKM dhe ministrive .....	45

## **LISTA E SHKURTESAVE**

1. ZKM ZYRA E KRYEMINISTRIT
2. MPB MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
3. MAPL MINISTRIA E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL
4. MASHTI MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT
5. MBPZHR MINISTRIA E BUJQËSISË PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
6. MD MINISTRIA E DREJTËSISË
7. MFPT MINISTRIA E FINANCAVE, PUNËS DHE TRANSFEREVE
8. MM MINISTRIA E MBROJTJES
9. ME MINISTRIA E EKONOMISË
10. MKK MINISTRIA PËR KOMUNITETE DHE KTHIM
11. MKRS MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT
12. MMPH MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
13. MPJD MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME DHE DIASPORËS
14. MSH MINISTRIA E SHËNDETËSISË
15. MINT MINISTRIA E INDUSTRIISË NDËRMARRËSISË DHE TREGTISË
16. MZHR MINISTRIA E ZHVILLIMIT RAJONAL
17. OJQ ORGANIZATA JO-QEVERITARE

## **PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

Ky raport pasqyron financimin publik për organizatat e shoqërisë civile (OJQ) gjatë vitit 2025, duke u bazuar në të dhënat e mbledhura përmes platformës online dhe raporteve të dorëzuara nga institucionet qendrore dhe komunale.

Në total, janë raportuar 16,540,346.10 euro fonde të ndara për projekte të ndryshme në fusha si arsimi, kultura, sporti, barazia gjinore dhe përfshirja sociale. Procesi i raportimit është kryer kryesisht përmes platformës online të financimit publik të OJQ-ve, duke rritur transparencën dhe qasjen publike në të dhëna.

Nga 57 institucione të detyruara të raportojnë, 50 prej tyre kanë dorëzuar raporte, ndërsa pjesa tjetër nuk kanë raportuar fare. Në nivel qendror, kanë raportuar të gjitha agjencitë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit dhe të gjitha ministrinë, ndërsa në nivel lokal kanë raportuar 31 komuna ndërsa 7 të tjera nuk kanë raportuar fare.

Në vitin 2025 shuma e përgjithshme e fondeve, nga niveli qendror (ZKM dhe ministrinë), shënon 9,557,175.20 € ndërkohë, niveli lokal ka ruajtur një financim pothuajse të qëndrueshëm, me një ulje të lehtë nga rreth 6,983,170.88 €.

Ky kombinim ka sjellë jo vetëm rritje të totalit, por edhe një diversifikim më të madh të projekteve të mbështetura. Përmirësimet teknologjike të platformës kanë lehtësuar raportimin dhe publikimin e të dhënave, megjithëse disa sfida mbeten, si harmonizimi i të dhënave dhe respektimi i afateve të raportimit.

Konkluzionet kryesore janë se procesi i financimit publik është duke u bërë më transparent dhe gjithëpërfshirës, por ka ende nevojë për përmirësime teknike dhe organizative. Rekomandimet kryesore përfshijnë forcimin e mekanizmave të kontrollit të brendshëm, respektimin e afateve të raportimit dhe mbështetjen e shtuar për stafin teknik.

Kjo përmbledhje synon t'i ofrojë lexuesit një pasqyrë të shpejtë dhe të plotë mbi gjetjet dhe rekomandimet e raportit, duke theksuar përkushtimin e institucioneve për transparencë, llogaridhënie dhe mbështetje efektive të shoqërisë civile.



## **FJALË HYRËSE**

Të nderuar/a,

Publikimi i Raportit Vjetor 2025 mbi Mbështetjen Financiare Publike për Organizatat Joqeveritare përfaqëson një arritje të rëndësishme institucionale për Republikën e Kosovës dhe një dëshmi të përkushtimit të vazhdueshëm për avancimin e transparencës, llogaridhënies dhe partneritetit me shoqërinë civile.

Gjatë këtij viti janë shënuar përpertime të rëndësishme në forcimin e kapaciteteve institucionale, veçanërisht në planifikimin dhe menaxhimin e proceseve të financimit publik të OJQ-ve, shpalljen e thirrjeve për financim, raportimin, si dhe administrimin e platformës online për financimin publik të organizatave joqeveritare.

Ky raport paraqet një pasqyrë gjithëpërfshirëse të fondeve të ndara dhe të mënyrës së përdorimit të tyre nga organizatat përfituese, duke vënë në pah rezultatet e arritura dhe ndikimin konkret në jetën e qytetarëve dhe komuniteteve. Njëkohësisht, ai reflekton angazhimin institucional për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të financimit publik dhe për forcimin e standardeve të transparencës dhe llogaridhënies.

Raporti riafirmon gjithashtu rëndësinë e bashkëpunimit të vazhdueshëm ndërmjet institucioneve publike dhe shoqërisë civile, si një element kyç për zhvillimin demokratik, shoqëror dhe ekonomik të vendit. Objektivat dhe orientimet strategjike për periudhën e ardhshme synojnë forcimin e mëtejshëm të këtij partneriteti dhe rritjen e efikasitetit të mekanizmave të financimit publik.

Megjithëse gjatë vitit janë hasur sfida të caktuara, përfshirë edhe probleme teknike me platformën elektronike që kanë ndikuar në vonesa në përpunimin e të dhënave, institucionet kanë vazhduar të përmbushin obligimet e tyre ligjore dhe administrative, përfshirë raportimin në platformë dhe dorëzimin me kohë të formularit F-20.

Përkushtimi i Zyrës për Qeverisje të Mirë mbetet një ndër prioritetet kryesore në avancimin e transparencës, llogaridhënies dhe qeverisjes së mirë në Republikën e Kosovës. Në këtë drejtim, Zyra do të vazhdojë të punojë ngushtë me institucionet publike, organizatat e shoqërisë civile dhe partnerët zhvillimorë për të siguruar zbatim sa më efektiv të politikave dhe standardeve që rregullojnë financimin publik të organizatave joqeveritare. Synimi ynë mbetet forcimi i besimit publik, rritja e

efikasitetit në përdorimin e fondeve publike dhe krijimi i një mjedisi sa më të favorshëm për zhvillimin dhe kontributin e shoqërisë civile në proceset demokratike dhe zhvillimore të vendit.

Shpreh mirënjohjen time për të gjitha institucionet publike, organizatat e shoqërisë civile dhe partnerët që kanë kontribuar në këtë proces të rëndësishëm. Bashkëpunimi dhe përkushtimi juaj mbeten thelbësorë për avancimin e mëtejshëm të sistemit të financimit publik dhe për forcimin e besimit të qytetarëve në institucionet tona.

Faleminderit për bashkëpunimin dhe përkushtimin tuaj të vazhdueshëm në këtë proces të përbashkët.

Me respekt,  
Habit Hajredini  
Drejtor  
Zyra për Qeverisje të Mirë / Zyra e Kryeministrit

## **1. HYRJE**

Rregullorja MF-Nr. 04/2017 për Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve përcakton detyrimet e institucioneve publike për raportimin e financimit të projekteve dhe programeve të OJQ-ve. Qëllimi i saj është të unifikojë të gjithë ciklin e financimit publik nga planifikimi, thirrjet publike, kontraktimi, monitorimi deri te raportimi.

Rregullorja përcakton jo vetëm rolin e Zyrës për Qeverisje të Mirë/Zyrës së Kryeministrit (ZQM/ZKM), por edhe të të gjitha institucioneve buxhetore për përgatitjen e raportit gjithëpërfshirës vjetor mbi mbështetjen financiare publike për OJQ-të. Në bazë të nenit 26, çdo organizatë buxhetore duhet të përgatisë raportin e saj për vitin fiskal paraparak dhe ta dorëzojë në ZQM/ZKM, si dhe ta publikojë në faqen e saj zyrtare.

Për vitin 2025, ZQM/ZKM ka mbledhur raportet e 15 ministrive dhe Zyrës së Kryeministrit , si dhe të 31 komunave, ndërsa 7 prej komunave nuk kane raportuar fare.

Ky raport gjithëpërfshirës për vitin 2025 pasqyron përkushtimin e institucioneve për transparencë, llogaridhënie dhe efikasitet në ndarjen e fondeve publike për shoqërinë civile.

### **1.1 Metodologjia e përdorur**

Zyra e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mirë (ZQM/ZKM), në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, ka ngritur një sistem transparent dhe të qëndrueshëm për financimin publik të organizatave të shoqërisë civile. Transparenca dhe llogaridhënia janë forcuar përmes zhvillimit dhe përmirësimit të Platformës Online për Financim Publik të OJQ-ve (<http://ojqfinancime.rks-gov.net>). Kjo platformë ofron të dhëna të detajuara sipas viteve, institucioneve, sektorëve dhe rajoneve, duke mundësuar raportim të drejtpërdrejtë dhe hierarkik nga të gjitha ministrinë dhe komunat.

Procesi i raportimit për vitin 2025 u bazua kryesisht në të dhënat e futura nga institucionet në platformë. Manualet dhe udhëzuesit teknikë janë shpërndarë për të lehtësuar punën e koordinatorëve, ndërsa është ofruar edhe mbështetje teknike për zyrtarët përgjegjës. Në disa raste, raportimi është bërë edhe përmes formularit standard F-20.

Përveç raportimit të drejtpërdrejtë, ZQM/ZKM ka analizuar faqet zyrtare të institucioneve për të shqyrtuar thirrjet publike, përmbajtjen dhe rrjedhën e procedurave për financim. Duhet theksuar se ZQM/ZKM nuk mban përgjegjësi për saktësinë e të dhënave të raportuara nga organizatat buxhetore. Avancimet teknologjike të platformës gjatë 2025–2026 kanë përfshirë: përmirësimin e funksionalitetit, mundësinë e raportimit masiv dhe ndërveprimin publik përmes grafikëve dhe filtrave të të dhënave. Megjithatë, sfida teknike dhe vonesat e raportimit nga disa institucione kanë ndikuar në publikimin me vonesë të raportit vjetor.

## **2.TË DHËNAT E PËRGJITHSHME PËR RAPORTIMIN NGA INSTITUCIONET/ORGANIZATAT BUXHETORE**

### **2.1 Raportimi nga organizatat buxhetore sipas rregullores**

Sipas Rregullores MF-Nr. 04/2017, çdo institucion buxhetor është i detyruar të përgatisë dhe të publikojë raportin vjetor për financimin e OJQ-ve. Për vitin 2025, nga 57 institucione të detyruara të raportojnë, raportet janë dorëzuar nga pjesa më e madhe e tyre, ndërsa disa nuk e kanë realizuar raportimin brenda afatit. Kjo ndikon drejtpërdrejt në nivelin e transparencës dhe llogaridhënies.

### **2.2 Digjitalizimi i raportimit**

Platforma online për financimin publik të OJQ-ve ka qenë mjeti kryesor i raportimit për vitin 2025. Institucionet qendrore dhe lokale kanë përdorur sistemin për futjen e të dhënave mbi thirrjet publike, projektet e kontraktuara dhe shumat e financuara. Digjitalizimi ka lehtësuar grumbullimin e të dhënave dhe ka mundësuar publikimin e tyre në kohë reale për publikun.

### **2.3 Përgjegjësitë dhe lidhja me ligjin për menaxhimin e financave publike**

Raportimi i financimit të OJQ-ve është i lidhur ngushtë me zbatimin e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi. Ky ligj kërkon që çdo shpenzim publik të dokumentohet dhe të publikohet, duke siguruar llogaridhënie dhe transparencë. Mos raportimi nga një pjesë e komunave dhe

organizatave buxhetore mbetet një sfidë për zbatimin e plotë të kësaj rregulloreje.

#### **2.4 Përmirësimet dhe sfidat në raportim**

Raportimi për vitin 2025 tregon përmirësim krahasuar me vitin paraprak, si në cilësinë ashtu edhe në nivelin e pjesëmarrjes së institucioneve. Megjithatë, mbeten disa sfida të dukshme: mosharmonizimi i të dhënave, raportimi me vonesë nga disa institucione, dhe mungesa e të dhënave të plota për disa projekte të financuara. Këto elemente e vështirësojnë krahasimin e saktë ndër vite.

#### **2.5 Pjesëmarrja e institucioneve në raportimin për vitin 2025**

Nga 57 institucione që kishin detyrim të raportojnë për vitin 2025, janë 50 që e përmbushën këtë obligim, ndërsa 7 nga to nuk dërguan raport. Në nivel qendror, të gjitha ministritë dhe zyrat e ZKM-së kanë dorëzuar raporte të plotë. Në nivel lokal, prej total 38 komunave, 31 prej tyre kanë raportuar për ndarje të fondeve për OJQ-të ndërsa 7 prej tyre nuk kanë dërguar raport fare. Ky nivel pjesëmarrjeje tregohet në figurat shoqëruese. Figura 1 paraqet 88% e institucioneve kanë raportuar për vitin 2025, duke reflektuar një nivel të lartë të përmbushjes së obligimeve.




Fig. 1 – Përqindja e institucioneve që kanë raportuar për mbështetje financiare për vitin 2025




Figura 2 – Përqindja e nivelit qendror që kanë raportuar për mbështetje financiare për vitin 2025

Fig. 2 pasqyron se nga j 15 ministri dhe nga Zyra e Kryeministrit ( 4 agjenci) prej tyre se 10 ministri dhe Agjencia për Barazi Gjinore në kuadër të ZKM-së kanë raportuar që kanë ndarë fonde ndërsa 5 ministri dhe tre agjencione ne kuadër te ZKM-së kanë raportuar që nuk kane ndarë fonde për financim të OJQ-ve që do tw thotë se nga 16 institucione kanë përkrahur 69 % projekte dhe 31% e tyre nuk kanë përkrah projekte.





Fig.3- Përqindja e nivelit lokal që kanë raportuar për mbështetje financiare për vitin 2025

Fig. 3 paraqet se prej total 38 komunave 28 prej tyre kanë raportuar se kanë ndarë fonde për mbështetje financiare të OJQ-ve, 3 prej tyre kanë raportuar se nuk kanë ndarë fonde për OJQ-te ndërsa 7 prej tyre nuk kane raportuar fare.



**Fig. 4 - Krahasimi i mbështetjes së OJQ-ve sipas niveleve**

Sipas figurës 4 vërehet ndarja e fondeve sipas nivelit qendror dhe lokal si dhe ndarja e fondeve sipas institucioneve në tërësi

#### 2.6 Fushat e financimit të projekteve të OJQ-ve nga ZKM /Ministritë dhe komunat për vitin 2025

Figura më poshtë paraqet fushat e financimit të projekteve të OJQ-ve nga ZKM /Ministritë dhe komunat për vitin 2025 bazuar në të dhënat e raportuara nga keto institucione në platformën për financim. Sipas këtyre të dhënave, fusha më e financuar ishte ajo e “Arti dhe Kultura”, me 507 ose 34% të fondeve të ndara. Pas saj renditen “Sporti” me 412 ose 28% fonde të ndara, “Fusha tjera të veprimit” me 158 ose 11% fonde të ndara, “Sherbime sociale” 132 ose 9% fonde të ndara etj.

### Fushat e financimit të projekteve të OJQ-ve nga ZKM dhe Ministritë dhe komunat 2025




Fig.5 Fushat e financimit të projekteve të OJQ-ve nga ZKM dhe Ministritë dhe komunat

Të dhënat ne figuren 6 tregojnë se financimi në nivel qendror është përqendruar në fushën “Art dhe Kulturë” rreth 247 ose 47% fonde te ndara, ndersa fushat tjera te veprimit kanë perfituar një pjese dukshem më të vogël të mjeteve financiare.

### Fushat e financimit të projekteve të OJQ-ve nga ZKM dhe Ministrinë për vitin 2025




Fig.7 Fushat e financimit të projekteve të OJQ-ve nga ZKM dhe Ministrinë

Ndërsa sa i perket financimit në nivel lokal në figuren 8 verehet se perqendrimi është në “Sport” rreth 412 ose 43% fonde të ndara duke pasuar me “Art dhe kulturë” rreth 260 ose 27% fonde të ndara ,ndersa fushat tjera kanë perfituar shumë më pak krahasuar me keto dy fusha.

## Fushat e financimit të projekteve të OJQ-ve nga Komunat 2025




Fig.8 Fushat e financimit të projekteve të OJQ-ve nga Komunat 2025

## 2. TË DHËNAT MBI FINANCIMIN PUBLIK SIPAS INSTITUCIONEVE

### 3.1 Shumat dhe projektet e mbështetura

Për vitin 2025, financimi publik për organizatat e shoqërisë civile është shpërndarë përmes institucioneve të ndryshme qendrore dhe lokale.

Shumat e ndara kanë mbuluar projekte të fokusuar në fusha të ndryshme si arsimi, kultura, sporti, të drejtat e njeriut, përfshirja sociale dhe barazia gjinore etj. Figurat me poshtë 9 dhe 10 tregojnë numrin e projekteve përfituese sipas nivelit lokal dhe qendror si dhe shumën e ndarë për projekte në nivelin lokal e qendror .




Fig.9- Numri i projekteve për OJQ-të sipas nivelit qendror dhe lokal (2025)

Mbështetja financiare publike për OJQ-të sipas nivelit qendror dhe komunal (2025)  
Total: 16,540,346.20 €




Fig.10- Mbështetja financiare publike për OJQ-të sipas nivelit qendror dhe komunal (2025)

### 3.2 Niveli qendror: ZKM dhe Ministrinë

Në nivel qendror, mbështetja financiare për OJQ-të është dhënë nga Zyra e Kryeministrit dhe ministrinë e linjës. Figura 11 paraqet numrin e projekteve të financuara sipas ministrive, ndërsa Figura 12 tregon shumatat e ndara. Disa ministri kanë pasur buxhet më të lartë për thirrje publike, ndërsa disa të tjera kanë mbështetur projekte me vlera më të vogla por me fokus të veçantë tematik.




Fig.11 – Numri i projekteve të ndara nga ZKM dhe ministrinë





Fig.12 – Shuma e mbështetjes financiare për OJQ-të nga secili institucion në nivelin qendror (2025)

### 3.3 Niveli lokal: Komunat

Komunat kanë një rol të rëndësishëm në financimin e OJQ-ve, sidomos në fushat që lidhen drejtpërdrejt me nevojat e komunitetit lokal. Për vitin 2025, shumica e komunave kanë shpallur thirrje publike dhe kanë mbështetur projekte në fusha si sporti, kultura, shërbimet sociale dhe rinia. Figura 13 paraqet numrin e projekteve të mbështetura sipas komunave, ndërsa Figura 14 tregon shumat e financuara nga komunat. Siç shihet edhe nga figurat e mëposhtme pasqyrohen dallime të mëdha mes komunave, ku Prizreni dhe Peja kanë ndarë shumën dukshëm më të lartë për projekte të shoqërisë civile në krahasim me komunat tjera.

Fig.13 Numri i projekte të mbështetura nga niveli komunal

Të dhënat për numrin e përfituesve (OJQ-ve) nga Komunat për vitin 2025






Fig.14 – Shuma e projekteve të mbështetura nga niveli lokal

### 3.4 Të dhënat e përgjithshme për vitin 2025

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të gjitha organizatat buxhetore që kanë raportuar për vitin 2025, përfshirë Zyrën e Kryeministrit, ministritë dhe komunat. Për secilin institucion jepet shuma totale e ndarë për mbështetjen e projekteve të OJQ-ve gjatë vitit. Këto të dhëna ofrojnë një pasqyrë të qartë mbi shpërndarjen e fondeve publike në nivel qendror dhe lokal, duke mundësuar identifikimin e institucioneve që kanë ndarë buxhet më të madh dhe atyre me fonde më të kufizuara. Analiza e tabelës tregon dallime të dukshme në kapacitetet financiare të institucioneve, ku disa ministri dhe komuna kanë siguruar mbështetje të konsiderueshme për shoqërinë civile, ndërsa të tjera kanë kontribuar në nivele më të ulëta. Kjo pasqyrë është themelore për të kuptuar trendin e përgjithshëm të financimit dhe për të vlerësuar shkallën e angazhimit të secilit institucion në fuqizimin e shoqërisë civile.

NR.	EMRI I ORGANIZATËS BUXHETORE	Shuma e dhënë nga institucionet për OJQ-të gjatë vitit 2025 (Euro)
	ZKM	
1	Zyra e Kryeministrit	32,000.00 €
	Ministritë	
1.	MKRS- Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit	5,390,870.00 €
2.	ME- Ministria e Ekonomisë	41,785.00 €
3.	MASHTI-Ministria e Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit	404,220.00 €
4.	MZHR- Ministria e Zhvillimit Rajonal	242,820.00 €
5.	MMPHI-Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës	400,000.00 €
6.	MD- Ministria e Drejtësisë	2,428,500.00 €
7.	MSH- Ministria e Shëndetësisë	94,974.30 €
8.	MAPL- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	65,000.00 €
9.	MKK- Ministria për Komunitete dhe Kthim	298,805.90 €
10.	MBPZHR-Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	158,200.00 €
11.	MINT- Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë	Ka raportuar se nuk ka përkrahur OJQ për vitin 2025
12.	MPB- Ministria e Punëve të Brendshme	Ka raportuar se nuk ka përkrahur OJQ për vitin 2025
13.	MPJD- Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës	Ka raportuar se nuk ka përkrahur OJQ për vitin 2025
14.	MM- Ministria e Mbrojtjes	Ka raportuar se nuk ka përkrahur OJQ për vitin 2025

15.	MFPT- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	Ka raportuar se nuk ka përkrahur OJQ për vitin 2025
	Gjithsej:	€ 9,557,175.20 €
	KOMUNAT	
1.	Komuna Deçan	74,500.00 €
2.	Komuna Dragash	204,000.00 €
3.	Komuna Drenas	133,425.00 €
4.	Komuna Fushë Kosovë	168,900.00 €
5.	Komuna Ferizaj	150,000.00 €
6.	Komuna Gjakovë	215,000.00 €
7.	Komuna Gjilan	154,400.00 €
8.	Komuna Graçanicë	492,595.00 €
9.	Komuna Hani i Elezit	26,000.00 €
10.	Komuna Istog	218,969.95 €
11.	Komuna Junik	3,000.00 €
12.	Komuna Kaçanik	102,300.00 €
13.	Komuna Kamenicë	164,651.48 €
14.	Klinë	85,500.00 €
15.	Komuna Klllokot	Ka raportuar se nuk ka përkrahur OJQ për vitin 2025
16.	Komuna Lipjan	167,471.00 €
17.	Komuna Malishevë	Ka raportuar se nuk ka përkrahur OJQ për vitin 2025
18.	Komuna Mamushë	Ka raportuar se nuk ka përkrahur OJQ për vitin 2025
19.	Komuna Mitrovicë	122,200.00 €
20.	Komuna Mitrovicë e Veriut	Nuk kane raportuar fare
21.	Komuna Novobërdë	223,570.91 €
22.	Komuna Obiliq	258,900.68 €
23.	Komuna Partesh	Nuk kane raportuar fare
24.	Komuna Pejë	397,700.00 €
25.	Komuna Podujevë	117,700.00 €
26.	Komuna Prishtinë	399,716.00 €
27.	Komuna Prizren	2,247,580.00 €
28.	Komuna Rahovec	223,700.00 €
29.	Komuna Ranillug	27,000.00 €
30.	Komuna Shtërpce	Nuk kanë raportuar fare
31.	Shtime	17,700.00 €

32.	KomunaSkenderaj	Nuk kanë raportuar fare
33.	KomunaTherandë	331,666.00 €
34.	Komuna Viti	150,000.00 €
35.	Komuna Vushtrri	105,024.86 €
36.	Komuna Zubin Potok	Nuk kanë raportuar fare
37.	Komuna Zveçan	Nuk kanë raportuar fare
38.	Komuna Leposaviq	Nuk kanë raportuar fare
Gjithsej:		6,983,170.88 €

Tabela 1 - Shuma e mbështetjes financiare për OJQ-të nga secili institucion në nivelin qendror 2025

### **3.5 Krahasimi ndër vite 2024–2025**

Në vitin 2025, shuma e përgjithshme e financimit publik të dedikuar për organizatat e shoqërisë civile ka 16,540,346.08 €. Figura 15 paraqet krahasimin e shifrave të vitit 2024 dhe 2025 për ZKM-në dhe ministrinë, ndërsa figura 16 paraqet numrin e projekteve të vitit 2024 dhe 2025 ZKM/Ministrinë. Këto të dhëna përbëjnë bazën për analizën e detajuar të trendëve dhe prioriteteve institucionale në financimin e OJQ-ve.

Krahasuar me vitin 2024, viti 2025 ka shënuar rënie të lehtë të shumës së përgjithshme të fondeve të ndara për OJQ-të. Figura 17 paraqet krahasimin paraqet krahasimin e shifrave të vitit 2024 dhe 2025 ne nivelin komunal, ndërsa figura 18 paraqet numrin e projekteve të vitit 2024 dhe 2025 ne nivelin komunal. Ky krahasim ndihmon të kuptohet trendi i mbështetjes institucionale dhe përpjekjet për të rritur transparencën.

Të dhënat krahasuese për financim publik të OJQ-ve për vitet 2024 dhe 2025 për ZKM-në /Ministritë




Fig.15- Të dhënat krahasuese për financim publik të OJQ-ve për vitet 2024 dhe 2025 për ZKM-në /Ministritë

Të dhënat krahasuese për numrin e projekteve për financim publik të OJQ-ve për vitet 2024 dhe 2025 për ZKM-në /Ministritë




Fig.16-Të dhënat krahasuese për numrin e projekteve për financim publik të OJQ-ve për vitet 2024/2025

Të dhënat krahasuese për financim publik të OJQ-ve për vitet 2024 dhe 2025 për komunitat




Fig.17 Të dhënat krahasuese për financim publik të OJQ-ve për vitet 2024 dhe 2025 per Komunitat

Të dhënat krahasuese për numrin e projekteve për financim publik të OJQ-ve për vitet 2024 dhe 2025 për Komunat




Fig.18 Të dhënat krahasuese për numrin e projekteve për financim publik të OJQ-ve për vitet 2024 dhe 2025 për Komunat

## **4. QËLLIMI I MBËSHTETJES FINANCIARE**

### **4.1 Objektivat e përgjithshme**

Mbështetja financiare publike për organizatat joqeveritare ka për qëllim forcimin e rolit të shoqërisë civile në zhvillimin demokratik, social dhe ekonomik të vendit. Përmes financimit publik synohet të rriten kapacitetet e OJQ-ve dhe të mbështeten projektet e iniciativat që ndikojnë pozitivisht në jetën e qytetarëve. Njëkohësisht, kjo mbështetje kontribuon në promovimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve publike dhe sektorit civil.

### **4.2 Platforma dhe mekanizmi i raportimit**

Platforma elektronike e raportimit ka luajtur rol të rëndësishëm në rritjen e transparencës dhe qasjes në informata lidhur me financimin publik të OJQ-ve. Përmes këtij sistemi, institucionet publikojnë të dhëna mbi thirrjet publike, projektet e mbështetura, kontratat dhe vlerat financiare të ndara. Kjo platformë ka ndihmuar në rritjen e besimit publik dhe ka krijuar mundësi më të lehta për monitorimin e procesit nga organizatat dhe qytetarët.

### **4.3 Avancimi i procesit të raportimit**

Digjitalizimi i procesit të raportimit ka ndikuar në përmirësimin e cilësisë dhe saktësisë së të dhënave të publikuara. Institucionet kanë arritur të raportojnë në mënyrë më efikase dhe më të strukturuar, ndërsa publiku ka pasur qasje më të shpejtë në informacione të përditësuara. Ky avancim ka ndikuar pozitivisht në rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe kontrollit publik mbi menaxhimin e fondeve publike.

### **4.4 Rekomandime për përmirësim**

Megjithëse janë shënuar përparime të konsiderueshme në procesin e raportimit, ende ekzistojnë fusha që kërkojnë përmirësim. Institucionet duhet të harmonizojnë mënyrën e raportimit të të dhënave, të shmangin vonesat në publikimin e raporteve dhe të ofrojnë trajnim dhe mbështetje teknike për personelin përgjegjës. Po ashtu, nevojitet forcimi i mekanizmave të kontrollit dhe verifikimit të të dhënave, me qëllim të sigurimit të saktësisë dhe besueshmërisë së informacionit të publikuar.

### **4.5 Përfitimet institucionale**

Financimi publik i OJQ-ve sjell përfitime të rëndësishme për institucionet dhe shoqërinë në përgjithësi. Ai ndihmon në krijimin e partneriteteve të qëndrueshme ndërmjet sektorit publik dhe organizatave joqeveritare, rrit transparencën institucionale dhe forcon besimin e qytetarëve ndaj institucioneve shtetërore. Për më tepër, përmes këtyre mbështetjeve financiare, institucionet arrijnë të realizojnë më me efikasitet objektivat e tyre strategjike dhe të kontribuojnë në ndërtimin e një shoqërie më demokratike dhe gjithëpërfshirëse.

## 5. TË DHËNAT E DETAJUARA PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE

### 5.1 ZKM dhe ministrinë

Në nivel qendror, Zyra e Kryeministrit dhe ministrinë kanë ndarë fonde të konsiderueshme për projekte të organizuar nga OJQ-të. Të dhënat tregojnë se një pjesë e madhe e buxhetit është orientuar drejt projekteve që lidhen me të drejtat e njeriut, zhvillimin e qëndrueshëm, edukimin dhe fuqizimin e rinisë.

NR.	EMRI I ORGANIZATËS BUXHETORE	RAPORTIMI NË ZQM BAZUAR NË RREGULLOREN MF-04/2017
ZYRA E KRYEMINISTRIT		
	ZYRA E KRYEMINISTRIT	<p>1. Agjencia për Barazi Gjinore ka raportuar direkt në platformë se gjatë vitit 2025 ka përkrahur organizata joqeveritare.</p> <p>2. Zyra e Komisionarit për Gjuhët, kanë raportuar se gjatë vitit 2025 nuk kanë përkrahur organizata joqeveritare.</p> <p>3. Zyra për Komunitete kanë raportuar se gjatë vitit 2025 nuk kanë përkrahur organizata joqeveritare.</p> <p>4. Zyra e Komisionarit për Persona të Pagjetur kanë raportuar se gjatë vitit 2025 nuk kanë përkrahur organizata joqeveritare.</p>
MINISTRITË E LINJËS		
1.	MINISTRIA E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL	MAPL ka raportuar direkt në platformë se gjatë vitit 2025 ka përkrahur organizata joqeveritare.
2.	MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT	MASHTI ka raportuar direkt në platformë se gjatë vitit 2025 ka përkrahur organizata joqeveritare..
3.	MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL	MBPZHR ka raportuar direkt në platformë se gjatë vitit 2025 ka përkrahur organizata joqeveritare..
4.	MINISTRIA E DREJTËSISË	MD ka raportuar direkt në platformë se gjatë vitit 2025 ka përkrahur organizata joqeveritare..
5.	MINISTRIA E FINANCAVE PUNËS DHE TRANSFEREVE	MFPT ka raportuar se gjatë vitit 2025 nuk ka përkrahur organizata joqeveritare.
6.	MINISTRIA E MBROJTJES	MM ka raportuar se gjatë vitit 2025 nuk ka përkrahur organizata joqeveritare.
7.	MINISTRIA MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPSIONR DHE INFRASTRUKTURËS	MMPHI ka raportuar direkt në platformë se gjatë vitit 2025 ka përkrahur organizata joqeveritare.
8.	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	MKRS ka raportuar direkt në platformë se gjatë vitit 2025 ka përkrahur organizata joqeveritare.
9.	MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME	MPB ka raportuar se gjatë vitit 2025 nuk ka përkrahur organizata joqeveritare.
10.	MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME DHE DIASPORËS	MPJD ka raportuar se gjatë vitit 2025 nuk ka përkrahur organizata joqeveritare.
11.	MINISTRIA E SHËNDETËSISË	MSH ka raportuar direkt në platformë se gjatë vitit

		2025 ka përkrahur organizata joqeveritare .
12.	MINISTRIA E EKONOMISË	ME ka raportuar direkt në platformë se gjatë vitit 2025 ka përkrahur organizata joqeveritare .
13.	MINISTRIA E ZHVILLIMIT RAJONAL	MZHR ka raportuar direkt në platformë se gjatë vitit 2025 ka përkrahur organizata joqeveritare
14.	MINISTRIA PËR KOMUNITETE DHE KTHIM	MKK ka raportuar direkt në platformë se gjatë vitit 2025 ka përkrahur organizata joqeveritare
15.	MINISTRIA E INDUSTRIË, NDËRMARRËSISË DHE TREGTISË	MINT ka raportuar se gjatë vitit 2025 nuk ka përkrahur organizata joqeveritare.

Tabela 2 – Pasqyra e raportimeve të financimit publik të OJQ-ve nga ZKM dhe ministrinë

Siç shihet në Tabelën 2, dallimet janë të dukshme: disa komuna kanë financuar vetëm një ose dy projekte, ndërsa të tjera kanë ndarë mbi dhjetë projekte. Kjo tregon qartë ndryshimet në prioritetet e politikave lokale dhe kapacitetet financiare të secilës komunë. Në Tabelën 3 shihet po ashtu se fusha e sportit dhe rinisë ka dominuar për nga numri i projekteve të mbështetura.

## 5.2 Komunat

Komunat kanë kontribuar ndjeshëm në mbështetjen e projekteve 29inist, të cilat kanë pasur ndikim të drejtpërdrejtë në komunitetet e tyre. Shumë komuna kanë financuar projekte në fushën e sportit, kulturës dhe integritimit social. Tabelat përkatëse japin një pasqyrë të qartë të ndarjes së fondeve sipas komunave.

NR.	EMRI I ORGANIZATËS BUXHETORE	RAPORTIMI NË ZQM BAZUAR NË RREGULLOREN MF-04/2017
KOMUNAT		
1.	KOMUNA E DEÇANIT	Komuna e Deçanit ka raportuar 29inist në platformë se gjatë vitit 2025 ka përkrahur organizata joqeveritare
2.	KOMUNA E DRAGASHIT	Komuna e Dragashit ka raportuar 29inist në platformë se gjatë vitit 2025 ka përkrahur organizata joqeveritare
3.	KOMUNA E FERIZAJT	Komuna e Ferizajt ka raportuar 29inist në platformë se gjatë vitit 2025 ka përkrahur organizata joqeveritare
4.	KOMUNA E FUSHË KOSOVËS	Komuna e Fushë Kosovës ka raportuar 29inist në platformë se gjatë vitit 2025 ka përkrahur organizata joqeveritare
5.	KOMUNA E GJAKOVËS	Komuna e Gjakovës ka raportuar 29inist në platformë/ gjatë vitit 2025 ka përkrahur organizata joqeveritare
6.	KOMUNA E GJILANIT	Komuna e Gjilanit ka raportuar 29inist në platformë se gjatë vitit 2025 ka përkrahur organizata joqeveritare
7.	KOMUNA E GLLOGOCIT/ DRENASIT	Komuna e Drenasit ka raportuar 29inist në platformë se gjatë vitit 2025 ka përkrahur organizata joqeveritare
8.	KOMUNA E GRAÇANICËS	Komuna e Graçanicës ka raportuar 29inist në platformë se gjatë vitit 2025 ka përkrahur organizata joqeveritare
9.	KOMUNA E HANIT TË ELEZIT	Komuna e Hanit të Elezit ka raportuar 29inist në platformë se gjatë vitit 2025 ka përkrahur organizata

		joqeveritare
10.	KOMUNA E ISTOGUT	Komuna e Istogut ka raportuar 3oinist në platformë se gjatë vitit 2025 ka përkrahur organizata joqeveritare
11.	KOMUNA E JUNIKUT	Komuna e Junikut ka raportuar 3oinist në platformë se gjatë vitit 2025 ka përkrahur organizata joqeveritare
12.	KOMUNA E KAÇANIKUT	Komuna e Kaçanikut ka raportuar 3oinist në platformë se gjatë vitit 2025 ka përkrahur organizata joqeveritare
13.	KOMUNA E KAMENICËS	Komuna e Kamenicës ka raportuar 3oinist në platformë se gjatë vitit 2025 ka përkrahur organizata joqeveritare
14.	KOMUNA E KLINËS	Komuna e Klinës ka raportuar 3oinist në platformë se gjatë vitit 2025 ka përkrahur organizata joqeveritare
15.	KOMUNA E KLLOKOTIT	Komuna e Kllokotit ka raportuar se gjatë vitit 2025 nuk ka përkrahur organizata joqeveritare.
16.	KOMUNA E LEPOSAVIQIT	Komuna e Leposaviqit nuk ka raportuar fare
17.	KOMUNA E LIPJANIT	Komuna e Lipjanit ka raportuar 3oinist në platformë se gjatë vitit 2025 ka përkrahur organizata joqeveritare
18.	KOMUNA E MALISHEVËS	Komuna e Malishevës ka raportuar se gjatë vitit 2025 nuk ka përkrahur organizata joqeveritare.
19.	KOMUNA E MAMUSHËS	Komuna e Mamushës ka raportuar se gjatë vitit 2025 nuk ka përkrahur organizata joqeveritare.
20.	KOMUNA E MITROVICËS SË VERIUT	Komuna e Mitrovicës Veriore nuk ka raportuar fare
21.	KOMUNA E MITROVICËS	Komuna e Mitrovicës ka raportuar 3oinist në platformë se gjatë vitit 2025 ka përkrahur organizata joqeveritare
22.	KOMUNA E NOVOBËRDËS/ ARTANËS	Komuna e Novobërdës ka raportuar 3oinist në platformë se gjatë vitit 2025 ka përkrahur organizata joqeveritare
23.	KOMUNA E OBILIQIT	Komuna e Obiliqit ka raportuar 3oinist në platformë se gjatë vitit 2025 ka përkrahur organizata joqeveritare
24.	KOMUNA E PARTESHIT	Komuna e Parteshit nuk ka raportuar fare
25.	KOMUNA E PEJËS	Komuna e Pejës ka raportuar 3oinist në platformë se gjatë vitit 2025 ka përkrahur organizata joqeveritare
26.	KOMUNA E PODUJEVËS/ BESIANËS	Komuna e Podujevës ka raportuar 3oinist në platformë se gjatë vitit 2025 ka përkrahur organizata joqeveritare
27.	KOMUNA E PRISHTINËS	Komuna e Prishtinës ka raportuar 3oinist në platformë se gjatë vitit 2025 ka përkrahur organizata joqeveritare
28.	KOMUNA E PRIZRENIT	Komuna e Prizrenit ka raportuar 3oinist në platformë se gjatë vitit 2025 ka përkrahur organizata joqeveritare
29.	KOMUNA E RAHOVECIT	Komuna e Rahovecit ka raportuar 3oinist në platformë se gjatë vitit 2025 ka përkrahur organizata joqeveritare
30.	KOMUNA E RANILLUGUT	Komuna e Ranillugut ka raportuar 3oinist në platformë se gjatë vitit 2025 ka përkrahur organizata joqeveritare

31.	KOMUNA E SHTËRPCËS	Komuna e Shtërpcës nuk ka raportuar fare .
32.	KOMUNA E SHTIMES	Komuna e Shtimes ka raportuar 31inist në platformë se gjatë vitit 2025 ka përkrahur organizata joqeveritare
33.	KOMUNA E SKENDERAJT	Komuna e Skenderajt nuk ka raportuar fare
34.	KOMUNA E SUHAREKËS/ THERANDËS	Komuna e Therandës/Suharekës ka raportuar 31inist në platformë se gjatë vitit 2025 ka përkrahur organizata joqeveritare
35.	KOMUNA E VITISË	Komuna e Vitisë ka raportuar 31inist në platformë se gjatë vitit 2025 ka përkrahur organizata joqeveritare
36.	KOMUNA E VUSHTRRIË	Komuna e Vushtrrisë ka raportuar 31inist në platformë se gjatë vitit 2025 ka përkrahur organizata joqeveritare
37.	KOMUNA E ZUBIN POTOKUT	Komuna e Zubin Potokut nuk ka raportuar fare
38.	KOMUNA E ZVEÇANIT	Komuna e Zveçanit nuk ka raportuar fare .

Tabela 3 – Pasqyra e raportimeve të financimit 31inist të OJQ-ve nga komunat

### 5.3 Numri I projekteve të mbështetura

Numri I projekteve të mbështetura në nivel kombëtar për vitin 2025 tregon një rritje të lehtë krahasuar me vitin 2024 sa i përket nivelit komunal ndërsa një rënie e lehtë sa i përket nivelit qendror. Përmes tabelave është paraqitur numri I projekteve të financuara sipas sektorëve kryesorë.

Nr.	Emri I Institucionit	Nr. I projekteve për OJQ-të përfituese gjatë 2025
I.	Zyra e Kryeministrit	3
II.	Ministritë	
1.	MKRS- Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit	350
2.	ME- Ministria e Ekonomisë	6
3.	MASHTI-Ministria e Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit	21
4.	MZHR- Ministria e Zhvillimit Rajonal	54
5.	MMPHI-Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës	2
6.	MD- Ministria e Drejtësisë	53
7.	MSH- Ministria e Shëndetësisë	11
8.	MAPL- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	1
9.	MKK- Ministria për Komunitete dhe Kthim	31
10.	MBPZHR-Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	18
11.	MINT- Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe	0

	Tregtisë	
12.	MPB- Ministria e Punëve të Brendshme	0
13.	MPJD- Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës	0
14.	MM- Ministria e Mbrojtjes	0
15.	MFPT- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	0
Numri total I projekteve për OJQ-të përfituese		550

Tabela 4 – Numri I projekteve të OJQ-ve të financuara nga ZKM dhe ministrinë

NR.	Emri I Institucionit	Nr. I projekteve të përkrahura
1.	Komuna Deçan	24
2.	Komuna Dragash	23
3.	Komuna Drenas	28
4.	Komuna F.Kosovë	59
5.	Komuna Ferizaj	54
6.	Komuna Gjakovë	55
7.	Komuna Gjilan	55
8.	Komuna Graçanicë	14
9.	Komuna Hani Elezit	9
10.	Komuna Istog	47
11.	Komuna Junik	5
12.	Komuna Kaçanik	23
13.	Komuna Kamenicë	49
14.	Komuna Klinë	25
15.	Komuna Klllokot	0
16.	Komuna Lipjan	39
17.	Komuna Malishevë	0
18.	Komuna Mamushë	0
19.	Komuna Mitrovicë	17
20.	Komuna Mitrovicë e Veriut	0
21.	Komuna Novobërdë	3
22.	Komuna Obiliq	34
23.	Komuna Partesh	0
24.	Komuna Pejë	73
25.	Komuna Podujevë	47
26.	Komuna Prishtinë	38
27.	Komuna Prizren	175
28.	Komuna Rahovec	30
29.	Komuna Ranillug	19
30.	Komuna Shtërpce	0
31.	Komuna Shtime	8
32.	Komuna Skenderaj	0
33.	Komuna Therandë	45
34.	Komuna Viti	29
35.	Komuna Vushtrri	16

36.	Komuna Zubin Potok	0
37.	Komuna Zveçan	0
38.	Komuna Leposaviq	0
	<b>Total</b>	<b>1043</b>

Tabela 5 – Numri I projekteve të OJQ-ve të financuara nga komunat

#### **5.4 Analiza krahasuese ndër vite**

Krahasimi I të dhënave ndërmjet viteve 2024 dhe 2025 tregon një tendencë të stabilitetit në shumën e përgjithshme të fondeve, me një rritje të lehtë të projekteve të financuara ne nivelin lokal. Ky trend pasqyron përkushtimin e institucioneve për të mbështetur shoqërinë civile dhe për të avancuar transparencën në ndarjen e fondeve publike. Figura 12 dhe tabelat përkatëse tregojnë qartë se rritja është më e dukshme në disa nga komunat më të mëdha, të cilat kanë ndarë fonde më të larta krahasuar me vitin e kaluar, ndërsa disa ministri më të vogla kanë shënuar rënie ose stagnim në financim.

Në raportin e vitit 2025, nga 57 institucione me obligim raportimi, 50 dorëzuan të dhëna, duke përfaqësuar rreth 87% të përgjithshme. Ky nivel është pak më i lartë krahasuar me vitin 2024, çka tregon një trend pozitiv në përfshirjen e institucioneve. Megjithatë, mbetet një numër i kufizuar komunash që nuk raportuan fare.

Një element i rëndësishëm është se një pjesë e institucioneve raportuan se nuk kanë ndarë fonde për OJQ-të gjatë vitit 2025. Këto raste, edhe pse nuk ndikojnë në rritjen e shumës totale, pasqyrojnë një nivel të ri të transparencës, pasi edhe mos financimi është bërë pjesë e raportimit zyrtar.

Përmirësimet teknologjike në platformën online dhe rritja e kapacitetit të koordinatorëve kanë lehtësuar procesin e raportimit dhe kanë bërë që shumica e institucioneve të dorëzojnë të dhëna më të sakta e të plota krahasuar me vitin 2024. Këto zhvillime dëshmojnë se trendi afatgjatë është pozitiv dhe tregon një orientim drejt një sistemi më transparent, gjithëpërfshirës dhe të besueshëm për mbështetjen e shoqërisë civile.

## 6. SQARIME SHITESË

- Meqenëse gjatë këtij viti janë paraqitur probleme teknike me platformën, në bashkëpunim dhe koordinim me të gjithë koordinatorët e institucioneve përgjegjëse në nivel lokal dhe qendror, është arritur pajtueshmëri që ata të na dorëzojnë formularin F20 të plotësuar. Më pas, Zyra për Qeverisje të Mirë ka bërë futjen e të dhënave drejtpërdrejt në platformë, me qëllim të shmangies së gabimeve dhe tejkalimit të problemeve teknike të lartpërmendura.
- **Raporti mbi subvencionimin e OJQ-ve dhe obligimet e bartura nga viti 2025 për komunën e Prizrenit**

Të bashkëngjitura i gjeni raportet lidhur me procesin e subvencionimit të organizatave joqeveritare (OJQ) si dhe pasqyrën e obligimeve të papaguara për vitin 2025 në Komunën e Prizrenit.

Gjatë vitit 2025, Komuna e Prizrenit ka mbështetur një numër organizatash joqeveritare përmes skemave të subvencionimit, në përputhje me prioritetet dhe planifikimet buxhetore të përcaktuara. Megjithatë, për shkak të kufizimeve buxhetore dhe mungesës së mjeteve financiare të mjaftueshme deri në fund të vitit fiskal, nuk ka qenë e mundur të realizohen të gjitha pagesat e parapara ndaj OJQ-ve përfituese.

Si rezultat, një pjesë e obligimeve financiare kanë mbetur të papaguara dhe janë bartur si obligime të hapura për vitin vijues. Këto obligime do të trajtohen dhe do të realizohen gjatë vitit 2026, në përputhje me mundësitë buxhetore dhe procedurat financiare në fuqi.

Për më shumë detaje lidhur me vlerat, përfituesit dhe statusin e pagesave, ju lutemi referojuni raporteve të bashkëngjitura.

<b>Obligimet e papaguara ndaj OJQ-ve nga viti 2025 për realizim në vitin 2026</b>			
1	OJQ "Doku Fest"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 51,000.00
2	SH.K.A "Agimi"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 27,000.00
3	OJQ "ACCI"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 16,800.00
4	OJQ "Durmish Aslano"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 5,000.00
5	SHKA "Katarina Josipi"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 3,500.00
6	OJQ "BTMD"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 2,000.00
7	OJQ "USUF"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 9,000.00

8	OJQ "KGBD"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 3,000.00
9	OJQ "Balkan Arena"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 8,000.00
10	OJQ "Zgjatma dorën"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 2,000.00
11	OJQ "Plejada"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 4,000.00
12	OJQ "Art fest"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 2,000.00
13	OJQ "Sarski Behar"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 8,000.00
14	OJQ "Norikum Kultur"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 3,000.00
15	OJQ "Let's do it"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 2,000.00
16	Lulu's Dance Academy	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 3,000.00
17	OJQ "Rythem"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 3,500.00
18	Autostrada Biennale	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 10,000.00
19	Pontis Ura	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 3,000.00
20	AKV "Lidhja e Prizrenit"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 32,000.00
21	OJQ "IKKS"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 3,500.00
22	OJQ "Tradita"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 5,000.00
23	OJQ "Kabashi i Vendit"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 4,000.00
24	OJQ "OHV"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 2,000.00
25	OJQ "Ec ma ndryshe"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 5,000.00
26	OJQ "N'gom fest"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 12,000.00
27	OJQ "Impakt +"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 7,000.00

28	OJQ "Esnaf"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 3,000.00
29	Fondacioni "Lumbardhi"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 3,500.00
30	OJQ "Drejtimi Jonë"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 3,000.00
31	OJQ "Pjetër Bogdani"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 8,500.00
32	OJQ "Elita"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 2,000.00
33	OJQ "Space ed"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 2,000.00
34	OJQ "Irrppz"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 3,000.00
35	OJQ "Zëri Aktiv Rinor"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 5,000.00
36	OJQ "SHESHR"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 4,000.00
37	OJQ "SHAEJ"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 3,500.00
38	OJQ "RAP"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 5,000.00
39	OJQ "Akademia	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 2,000.00
40	OJQ "Idea"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 2,000.00
41	OJQ "Globeds"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 4,000.00
42	OJQ "Astrovire"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 2,500.00
43	Frymë rinore për zhvillim kulturë dhe edukim	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 4,500.00
44	"YDC"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 2,000.00
45	KB "Bashkimi"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 95,000.00
46	KBF "BASHKIMI 1965"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 15,000.00

47	KH "Prizreni" F	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 2,500.00
48	KB "New Basket"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 2,000.00
49	KM "Vëllazëria"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 2,500.00
50	Klubi i Boksit "Prizreni"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 4,500.00
51	SHB "Sharri"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 2,000.00
52	Klubi i Karatesë "Eagle"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 4,000.00
53	KF "Arbanasi"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 5,000.00
54	KÇ "Prizreni"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 2,500.00
55	KPP "Shkolla Prizreni"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 2,500.00
56	Klubi i Bilardos "Prizreni 1890"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 3,500.00
57	Klubi i Çiklizmit "Probike"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 3,500.00
58	KB "Ponte Prizren"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 11,000.00
59	Klubi i Volejbollit "Prizreni"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 2,000.00
60	KH "Click"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 2,000.00
61	SHMP "Shqiponjat"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 5,000.00
62	Klubi i Mundjes "Prizreni"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 2,000.00
63	KB "Junior o6"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 9,000.00
64	KPP "Bashkimi"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 2,000.00
65	KM "Kolosi"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 4,000.00
66	SHAM AK "Prizreni"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 5,000.00

67	SHB "Gashjanët e Vilhenit"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 5,000.00
68	Klubi i Atletikës "Prizreni"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 5,000.00
69	KS "Megasports"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 25,000.00
70	SHP "Elita"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 2,000.00
71	KPP "Liria"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 5,000.00
72	KF "Arbana"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 7,000.00
73	Klubi i Kajakut "Lumbardhi"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 8,000.00
74	KPP "Lidhja e Prizrenit"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 2,500.00
75	Klubi i Karatesë "K-Dant Drini"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 4,000.00
76	KVF "Prizren masters"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 3,800.00
77	KP "Kabashi"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 2,500.00
78	KVF "Veteranët"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 3,600.00
79	Oldtimer Club Prizreni	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 4,000.00
80	KVF "Liria"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 3,500.00
81	ASZ "Berisha Brothers"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 6,000.00
82	KVF "Kabashi"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 3,000.00
83	KH "Prizreni" M	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 2,000.00
84	3x3 Prishtina	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 28,000.00
85	KF "Winner"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 5,000.00
86	Shoqata e Beshiktashit	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 7,500.00

87	Nature Lovers Group	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 3,500.00
88	SHF "Albionët"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 2,000.00
89	SHF "Arasta"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 2,000.00
90	SHF "Prizreni 2017"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 2,000.00
91	KF "Progres export"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 3,000.00
92	Klubi i Shigjetarisë Tradicionale	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 2,000.00
93	Klubi i Karatesë "Prizreni"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 4,000.00
94	OJQ "LVRK"	Kulture ,Rini dhe Sport	€ 2,000.00
			<b>€ 635,200.00</b>
1	OJQ "SAKUNTALA"	Sherbime Sociale	1,650,00
2	OJQ "SUKSESI"	Sherbime Sociale	€ 4,000.00
3	OJQ "PMSH "	Sherbime Sociale	€ 7,500.00
4	OJQ "SHFAK"	Sherbime Sociale	€ 1,850.00
5	OJQ "RONA"	Sherbime Sociale	€ 2,350.00
6	OJQ "GRAT BURRNESHA "	Sherbime Sociale	€ 2,800.00
7	OJQ "FEMINALE "	Sherbime Sociale	€ 2,100.00
8	OJQ "HADER"	Sherbime Sociale	€ 6,650.00
9	OJQ "HANDIKOS"	Sherbime Sociale	€ 8,500.00
10	OJQ "LABIRINTHY "	Sherbime Sociale	€ 3,900.00
11	OJQ "OPDMK"	Sherbime Sociale	€ 3,500.00
12	OJQ "KKYD"	Sherbime Sociale	€ 1,750.00
13	OJQ "STEP"	Sherbime Sociale	€ 1,350.00
14	OJQ "RREZON"	Sherbime Sociale	€ 9,100.00
15	OJQ "DOWN SYNDROM KOSOVA "	Sherbime Sociale	€ 9,900.00

16	OJQ"SHHBK NENA TEREZE"	Sherbime Sociale	€ 3,400.00
17	OJQ"SHNVPZ"	Sherbime Sociale	€ 3,000.00
18	OJQ"OFAP"	Sherbime Sociale	€ 9,800.00
19	OJQ"SHKPP"	Sherbime Sociale	€ 7,500.00
20	OJQ"AUTIZMI "	Sherbime Sociale	€ 7,800.00
			<b>€ 96,750.00</b>
1	Educo	Drejtoria per Turizem dhe Zhvillim Ekonomik	€ 4,900.00
2	Bellavita	Drejtoria per Turizem dhe Zhvillim Ekonomik	€ 4,000.00
3	OASIS	Drejtoria per Turizem dhe Zhvillim Ekonomik	€ 4,300.00
4	RETV	Drejtoria per Turizem dhe Zhvillim Ekonomik	€ 3,000.00
5	Sharri Wild	Drejtoria per Turizem dhe Zhvillim Ekonomik	€ 3,000.00
6	Dezena	Drejtoria per Turizem dhe Zhvillim Ekonomik	€ 3,000.00
7	CBOX	Drejtoria per Turizem dhe Zhvillim Ekonomik	€ 4,500.00
8	Green Leaders Besila	Drejtoria per Turizem dhe Zhvillim Ekonomik	€ 3,000.00

9	ITI Pro Kosova	Drejtoria per Turizem dhe Zhvillim Ekonomik	€ 3,000.00
10	Geni dhe Shpresa	Drejtoria per Turizem dhe Zhvillim Ekonomik	€ 3,000.00
11	Evolution	Drejtoria per Turizem dhe Zhvillim Ekonomik	€ 4,500.00
12	SH B Haxhi Beda	Drejtoria per Turizem dhe Zhvillim Ekonomik	€ 3,500.00
13	Deti dhe Ceni	Drejtoria per Turizem dhe Zhvillim Ekonomik	€ 3,800.00
14	Ljubinski Horizont Planinar	Drejtoria per Turizem dhe Zhvillim Ekonomik	€ 2,000.00
15	Empati	Drejtoria per Turizem dhe Zhvillim Ekonomik	€ 4,000.00
16	Florg	Drejtoria per Turizem dhe Zhvillim Ekonomik	€ 2,000.00
17	Eksploro Shqip	Drejtoria per Turizem dhe Zhvillim Ekonomik	€ 4,400.00
18	Foleja	Drejtoria per Turizem dhe Zhvillim Ekonomik	€ 2,000.00

19	Klubi Alpin Kokekrisurit	Drejtoria per Turizem dhe Zhvillim Ekonomik	€ 2,500.00
20	Triharqe	Drejtoria per Turizem dhe Zhvillim Ekonomik	€ 2,300.00
21	Kosova Kadin Girisimciler D	Drejtoria per Turizem dhe Zhvillim Ekonomik	€ 2,400.00
22	Sweet World	Drejtoria per Turizem dhe Zhvillim Ekonomik	€ 4,500.00
23	Drite ne sy tane	Drejtoria per Turizem dhe Zhvillim Ekonomik	€ 4,000.00
24	Prizren Frames	Drejtoria per Turizem dhe Zhvillim Ekonomik	€ 3,800.00
25	Shqiponjat e Sharrit	Drejtoria per Turizem dhe Zhvillim Ekonomik	€ 3,700.00
			<b>€ 85,100.00</b>
1	Jetimat e Ballkanit	Zyra e Kryetarit	€ 500,000.00
2	Concordia	Zyra e Kryetarit	€ 25,000.00
			<b>€ 525,000.00</b>

Sipas tabelës shohim se gjithsejt obligime te mbetura prej vitit 2025 kane mbetur gjithsej **1,342,050.00 €** te cilat nuk kane arritur te përfundohen per shkak te fondeve të pamhjaftueshme.

Sa i perket Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural -pas procesit të monitorimit dhe vlerësimit të projekteve/programit të organizatave përfituese, Ekipi Monitorues ka shqyrtuar raportet narrative dhe financiare të secilës organizatë. Bazuar në gjetjet e monitorimit, për organizatat e mëposhtme projektet/programet nuk janë aprovuar tërësisht ose pjesërisht, ndërsa për shumat e paaprovuara janë ndërmarrë procedura ligjore për kthimin e mjeteve.

<b>Nr.</b>	<b>OJQ / Organizata</b>	<b>Shuma Totale e Projektit (€)</b>	<b>Shuma e Aprovuar nga Ekipi Monitorues (€)</b>	<b>Statusi</b>
1	Nisma për Rini dhe Invacion (NRI)	-	0.00	Projekti/programi nuk është aprovuar; është bërë padi gjyqësore për kthimin e mjeteve.
2	Research RCH	-	0.00	Projekti/programi nuk është aprovuar; është bërë padi gjyqësore për kthimin e mjeteve.
3	Iniciativa Rinore Aktive (IRA)	-	0.00	Projekti/programi nuk është aprovuar; është bërë padi gjyqësore për kthimin e mjeteve.
